

Thanas Boçi, vështrim mbi romanin “1803”, të autorit Besim Xhelili

Athinë, 10 maj 2016

Besim Xhelili është autor i pesë vëllimeve poetike dhe i një romani. Përvojat e jetës, ambientet ku është lindur e rritur dhe ku jeton e punon dhe kontaktet me letërsinë e tyre, me mitet dhe legjendat, falë talentit të tij të lindur, pa dyshim që e bënë poet, i cili, tanimë i ka shtruar shinat e krijimtarisë së tij, dhe ecën i sigurt në to.

Nga poezia e tij nuk kam lexuar, por duke parë ato që ka në roman, më forcon bindjen se ajo do të jetë edhe në të pesë vëllimet poezi metrike me rimë, melodioze me akorde minore që të ngacmojnë emocionalisht.

Romani i tij “1803”, me një titull tepër sinjikativ është i zhanrit social-erotik, por përditshmëria përbëhet edhe nga elementët e saj si: puna, familja, mërgimi, etnia, kultura, arti, poezia, jeta urbane apo edhe dashuria, duke kaluar në filtrin e talentit të autorit, përbëjnë edhe atë që quhet plotëri e përbërësve të subjektit; ndaj thjeshtësia e të rrëfyerit dhe fabulës nis me lindjen e ndjenjës së dashurisë më 18 mars (18-03), dhe vazhdon me luftën, peripecitë për të mposhtur pengesat, mentalitetet, zakonet, disi tashmë të tejkaluara në kohë, gjersa arrin finishin e zgjidhjes së çështjes në funksion të dëshirës të të dyve: Besarit dhe Samirës. Dhe të gjitha këto përshkohen fund e krye nga përshkruarja e të gjitha ngjarjeve a rrethanave nga dimensionin e lirisë të mendimit, e shfaqur në mesazhe të qarta, konkrete dhe të kapshme nga lexuesi.

Autori Besim Xhelili për t’na bërë të njohur gjithçka, ka marrë si njësi të dimensionit estetik rrëfimin e tij, të kombinuar me dialogjet, andaj bën edhe personalizimin e narracionit të ngjarjeve, duke ia atribuuar kështu ato të personazhit kryesor, që është vetë autori dhe partneres së tij Samira, kështu që e bën të tillë, duke qenë vetë i kudondodhur, gjithçka bëhet më e besueshme, më bindëse, më e afërt, më emocionale. Sigurisht midis realiteteve që paraqiten dhe qëndrimit filozofik të autorit, kur çdo gjë, çdo ditë, sjellje të personazheve e aktorëve, i nënshtrohen një filtri filozofik, se s’mund të ketë letërsi të bukur pa filozofinë brenda saj, veçse kështu mesazhet përcillen të qartë, ngacmues e që ndikojnë në botën e brendshme të lexuesve, sepse ky është edhe misioni qytetar dhe estetik i artit dhe i letërsisë. Shumë ngjarje, shumë aspekte që paraqiten në roman janë si rezultat i përsiatjeve dhe kujtimeve të autorit. Duke iu referuar filozofisë së Bergusonit për letërsinë e “Përroit Psikik”, të përfaqësuar nga Xhojsi e Kafka thuhet se “Kujtimet nuk përfaqësojnë jetën e njeriut, por jeta jetohet nga

vetë kujtimet”, që ka gjetur zbatim në të gjitha krijimet surrealistike që kanë në themel të tyre persiatjet dhe imazhet. Pra, ashtu siç paraqiten në roman të gjithë elementët parësorë të tij, përbëjnë edhe atë që quhet stil, pra të përbashkët në të gjithë krijimtarinë, të cilët përcaktojnë edhe gjendjen afektive në raportin krijues-lexues. Këto efekte shpjegohen më mirë sipas eksperimenteve postfunktionale të filozofisë freudiste. Edhe gjeniu i madh gjerman i letrave Gëte, ndonëse më herët, për këtë shprehet: “Sikur të mundja të llogarisja gjithçka që kam trashëguar nga paraardhësit e mi dhe bashkëkohësit e mëdhenj, peshorja nuk do të anonte nga ana ime”. Kjo do të thotë që një vepër nuk duhet që t’i pëlqejë krijuesit, por atyre të cilëve u drejtohet, njerëzve si konsumatorë të tyre. Besoj se ky është edhe qëllimi, edhe misioni i autorit të romanit “1803”.

Gjatë leximit të librit të bie në sy një aspekt i rëndësishëm siç është ai i kujtesës mbi kohën, një kërkesë imediate për letërsinë. Koha, historia, vendet që shkelen nga shkrimtari nuk lihen në harresë. Më vjen mirë që autori ka qenë edhe në Plazhin e Shpellës, në fshatin tim në Lukovë, apo vlerësimi dhe dedikimi i vendeve si Butrinti, Kruja, Vlora, Prishtina, Tetova, Skënderbeu, Naim Frashëri etj. Kjo përcakton edhe gjeografinë e romanit. Dimensionet estetike të trajtimit të romanit janë të shumta. Përveç rrëfimit patetik të autorit, nuk mund të lihen në harresë edhe të tjera, siç janë surprizat e të papriturat, këto janë të shumta, por të shtruar organikisht në të gjitha faqet, por ashtu edhe figurat artistike, siç mund të jenë: detajet, tablotë, personazhet e kontaktet, peisazhet, strukturat gramatikore të cilat bindëse dhe reale.

Romani ka një unitet të brendshëm, pse jo edhe një universalitet psikologjik që të tërheq e të mbanë lidhur për sa kohë e lexon, sepse arti dhe letërsia, për vetë vlerat që krijojnë, ndikojnë drejtpërsëdrejti në botën e brendshme të njerëzve.

Në roman është vizatuar me ngjyra të qarta e bukura, që ka brenda madhështisë dhe të ngacmon me mesazhet që përcjell, si mision primar që ka. Më lart përmendëm një nga vlerat e romanit, që është ai i kohës. Vërtetë që koha është njëdimensionale, por ajo shtrirje në parakohësi, njëkohën dhe paskohën, gjë që do të thotë se vlera e një vepre artistike ka rëndësi që ajo të jetë permanente, e ato të shtyhen në paskohësi. Kjo ndërthurje midis hapësirës dhe kohës, edhe sipas Ajnshtajnit, krijon universalitetin e një vlere katërdimensionale. Këto i kanë parasysh estetët strukturalikë, por edhe autori i romanit që po diskutojmë. Krijimi i ndërgegjes estetike mbetet nga prioritetet e shkrimtarëve dhe artistëve. Këtu luajnë një rol të rëndësishëm veçantë krijuese të autorit, siç mund të jenë talenti, përvoja, vullneti, biografia artistike, predispozitat psikofizike, edukata, botëkuptimi, ideali estetik, jeta sociale etj., të cilat mesa konstatoj unë nga leximi

i romanit, pothuajse i ka të gjitha. Kjo duket si dukuri e veçantë tek poetizimi i prozës, për arsye që u përmendën edhe më lart, inercia poetike vazhdon dhe mbetet një tipar i personalitetit letrar, gjë për të cilën theksojmë strukturat sintaksore të gjuhës së shkruar, tingëllon si poezi, dhe shkrimtari Besim Xhelili na atribuohet si një poet i një proze të bukur.

Analiza që i ka bërë Prend Buzhala romanit, është një vlerësim real dhe objektiv me kompetencë shkencore dhe estetike.

Me këtë roman Besim Xhelili tregon se e ka të hapur trasenë në fushën e prozës dhe zhanrit të romanit. E gjithë krijimtaria e tij, por në veçanti romani që e njohim luan një rol të rëndësishëm në edukimin e ndërgjegjes estetike.